

VENDIM
Nr. 333, datë 22.5.2019

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKUALIFIKIM I SHESHIT TE LAGJJA ‘LUGINA’, BASHKIA
SHIJAK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim i sheshit te lagjja ‘Lugina’, Bashkia Shijak”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Shijak.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë truall”, me sipërfaqe 600 m², me vlerë të përgjithshme prej 1 828 200 (një milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e dyqind) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 828 200 (një milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e dyqind) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Shijak, planifikuar në buxhetin e saj me vendim të këshillit bashkiak.
 5. Shpronësimi të fillojë menjëherë dhe të përfundojë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 6. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur pranë Bashkisë Shijak certifikatën e pronësisë, hartën treguese të regjistrimit, si dhe kartelën e pasurisë.
 7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Shijak të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.
 8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Shijak, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Shijak.
 9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 10. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit: “Rikualifikim i sheshit tek lagjja Lugina” Bashkia Shijak

Tabela me numër pasurie 6/298

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. i pasurisë	Zona Kadastrale	Sipërfaqja truall/m ²	Çmimi/lekë/m ²	Vlera totale/lekë	Dokumenti i pronësisë
1	Abdyl Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Hysni Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Nafie Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Servete Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Zenepe Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
Totali						914 100	

Tabela me numër pasurie 6/299

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. i pasurisë	Zona Kadastrale	Sipërfaqja truall/m ²	Çmimi/lekë/m ²	Vlera totale/lekë	Dokumenti i pronësisë
1	Abdyl Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Hysni Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Nafie Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Servete Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Zenepe Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
Totali						914 100	

Vlera e përgjithshme e dy pasuritve: nr 6/298 dhe nr. 6/299 është:	1 828 200 lekë
---	-----------------------